



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

Gjetjet kryesore të Anketës “COVID-19 mbi bizneset”

Përgatitur nga Sekretariati i Këshillit të
Investimeve

Qershor 2020

I. Tabela e Përmbajtjes

I.	HYRJE	2
II.	GJETJET KRYESORE	2
III.	METODOLOGJIA.....	4
	QËLLIMI I ANKETIMIT	4
	STRUKTURA E PYETSORIT	4
	METODA E SHPËRNDARJES SË PYETËSORIT.....	5
	METODA PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE	5
IV.	KAMPIONI.....	6
V.	REZULTATET E ANKETIMIT.....	7
	NDIKIMI I COVID19	7
	COVID-19 IMPLIKIMET NDAJ BIZNESIT	11
	NDËRHYRJET E QEVERISË.....	20
	COVID19 -TEKNOLOGJIA DHE BIZNESI	24
	PLANI I EMERGJENCËS	25
SHTOJCA		27
	SHTOJCA 1 – MASAT E SUGJERUAR NGA SEKTORI I BUJQËSISË.....	27
	SHTOJCA 2 - MASAT E SUGJERUAR NGA SEKTORI I NDËRTIMIT	30
	SHTOJCA 3 - MASAT E SUGJERUAR NGA SEKTORI I INDUSTRIË.....	31
	SHTOJCA 4 – MASAT E SUGJERUAR NGA SEKTORI I TURIZMIT.....	33
	SHTOJCA 5 – MASAT E SUGJERUAR NGA SEKTORI TREGTI	36
	SHTOJCA 6 – MASAT E SUGJERUAR NGA SEKTORI SHËRBIME.....	38
	SHTOJCA 7 – PYETËSORI	40

I. Hyrje

Koronavirusi i ri që u shfaq në Wuhan, Kinë, në dhjetor 2019, u zgjerua duke prekur pothuajse çdo cep të globit. Në Shqipëri për herë të parë u konfirmua zyrtarisht në 8 Mars 2020. Pas përhapjes së tij (COVID-19), Këshilli i Ministrave vendosi të shpallte gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

Nëse objektivi i parë i çdo qeverie ishte sigurimi i burimeve të nevojshme për emergjencat mjekësore, padyshim objektivi i dytë ishte marrja e masave mbështetëse për të mbrojtur ekonominë nga një kolaps i mundshëm. Ende nuk ka të dhëna të sakta për të përcaktuar saktësisht se çfarë dëmi ka pësuar ekonomia globale nga pandemia COVID-19, por duket se ka një dakortësi mes ekonomistëve se pandemia do të ketë ndikime të mëdha negative në ekonominë botërore.

Në përgjigje të situatës së jashtëzakonshme, Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI) në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE), nisi një anketim mbi *'Vlerësimin e Ndikimit të Pasojave që rrjedhin nga Pandemia e COVID-19 mbi Aktivitetin e Biznesit në Shqipëri,'* me qëllim identifikimin e problematikave kryesore dhe sugjerimet për përballjen e situatës nga perspektiva e biznesit.

Ky raport paraqet rezultatet e anketimit që filloi më 28 Mars dhe vazhdoi deri më 5 maj 2020.

Anketimi kishte për qëllim grumbullimin e informacionit mbi ndikimin e COVID-19 në veprimtarinë e biznesit që operon në Shqipëri, sipas sektorëve të veçantë, madhësisë së kompanive dhe numrit të të punësuarve. Anketa synoi të japë përgjigje pyetjeve të tilla si: *"Si po reagojnë kompanitë në këtë situatë të paprecedentë dhe me çfarë sfidash po përballen për sa i përket likuiditetit, mungesës së prodhimit, mungesës së klientëve, rritjes së kostove, etj. Cilat janë vlerësimet e tyre mbi ndikimin e COVID-19 në xhiron vjetore të biznesit të tyre? Si mundet qeveria qendrore dhe lokale të ndihmojnë duke patur parasysh nevojat specifike gjatë kësaj periudhe¹?"*

II. Gjetjet Kryesore

- **Të gjithë sektorët e ekonomisë pritet të ndikohen negativisht.** Kështu, 97 % e kompanive presin që aktiviteti i tyre të ndikohet shumë negativisht dhe negativisht nga përhapja e koronavirusit të ri. Vetëm bujqësia në 4.8% të saj mendon se nuk do të ndikohet. Gjithashtu, 62% e eksportuesve presin që të ndikohen shumë negativisht.
- Theksojmë se **47% e ndërmarrjeve ndaluan plotësisht aktivitetin** gjatë COVID-19, ndërsa 53% e tyre vazhduan aktivitetin plotësisht ose pjesërisht. Nga të gjithë sektorët e ekonomisë, turizmi rezultoi si më i prekuri me një mbyllje të veprimtarisë deri në 75%. Në të kundërt, sektori i bujqësisë deklaroi se vazhdoi punën pjesërisht ose plotësisht në 81% të saj.
- Pavarësisht nga madhësia apo sektori, të gjitha kompanitë konvergojnë në lidhje me pritshmëritë mbi ndikimin e COVID19 në xhiron vjetore të tyre - **80% e kompanive vlerësojnë se do të kenë më shumë se 20% rënie të qarkullimit vjetor të tyre.**
- Në lidhje me problematikën më të shpeshta, kompanitë gjatë COVID-19, theksojnë **mungesën e klientëve, mungesën e likuiditetit, vështirësitë në likuidimin të pagave dhe respektimi i detyrimeve dhe pagesave tatimore.** Më konkretisht, Bujqësia, Industria dhe

¹ Shtojcat për më shumë detaje

ndërtimi konvergojnë në mungesën e likuiditetit si shqetësimi kryesor i tyre; ndërsa turizmi, shërbimet dhe tregtia theksojnë mungesën e klientëve.

- Sa i përket importeve, 52% e kompanive deklarojnë se kanë pasur **probleme me importet, kryesisht nga vendet e BE-së**. Nje pjese e tyre (69%) në kuadrin e vazhdimësisë së punës janë dëmtuar seriozisht pasi janë shumë të varur nga importet, ndërkohë që 31% e tyre po konsiderojnë zëvendësimin me produkte vendase pjesërisht apo plotësisht. Industria rezulton me varësi më të madhe nga Importet (83% e kompanive deklarojnë se varen plotësisht nga importet); Ndërsa ndërtimi është më pak i varur (vetëm 29% e kompanive). Theksojmë se vetëm 2% e kompanive që operojnë kryesisht në Tregti, Industri dhe Shërbime deklarojnë se **mund të zhvendosen plotësisht nga importet drejt burimeve kombëtare për të siguruar vazhdimësinë e biznesit**;
- Kompanitë, janë gjendur të papërgatitur për të përballuar pamundësinë e forcës së punës për t'u paraqitur në punë. Kështu, 37% e ndërmarrjeve konfirmojnë se **nuk kanë arritur të marrin asnjë masë në kohë për ta adresuar këtë sfidë, ndërkohë që 33% përdorën lejët e zakonshme dhe punë nga shtëpia (kryesisht shërbimet), ndërsa pjesa tjetër përdorën** largimet nga puna (më së shumti ndërmarrjet e mëdha 67%).
- **Për të siguruar vazhdimësinë e biznesit, kompanitë deklarojnë se kryesisht do të përdorin të ardhura të mëparshme të akumuluar (34%) si edhe do të ulin kostot (32%) fokus** shkurtimi i vëndeve të punës ose ulja e prodhimit. Marrja e kredisë në bankë konsiderohet si opsioni i tretë. Më specifikisht nga pikpamja sektoriale, bujqësia, ndërtimi dhe tregtia konsiderojnë mbështetjen me hua bankare. Ndërsa, industria dhe turizmi fokus do të kenë uljen e kostove ndërsa shërbimet kryesisht do të përdorin të ardhurat e tyre të akumuluar. Në një analizë më të thelluar, rezulton se sipas madhësisë, kompanitë me të ardhura mbi 8 milion lekë shprehen se do të ulin kostot për të siguruar vazhdimësinë e biznesit ndërsa kompanitë me qarkullim deri në 8 milion lekë do synojnë të përdorin të ardhurat e akumuluar për të siguruar vazhdimësinë e biznesit;
- Pavarësisht nga madhësia ose sektori, **shumica e kompanive vlerësojnë se ndikimi COVID19 do të zgjasë deri në 1 vit**
- Për sa i përket **vlerësimit të masave mbështetëse të qeverisë**, kompanitë me xhiro mbi 14 milion lekë vlerësojnë se shtyrja e pagesave të kredive do të ketë ndikimin më pozitiv; ndërkohë nga biznesi me xhiro deri në 14 milion lekë vlerësohet se mbështetja financiare për punonjësit do të ketë një ndikim të madh pozitiv.
- COVID 19 stimuloi ndërgjegjësimin mbi efikasitetin e përdorimit të shërbimeve online dhe investimet në teknologji. Kështu, 75% e kompanive deklarojnë se i kanë përdorur shërbimet online (kryesisht Shërbimet, Turizmi dhe Industria); ndërkohë që 81% e tyre konfirmojnë që **do të vazhdojnë të përdorin përsëri shërbimet online. Kjo është një** tendencë që konvergon për të gjithë sektorët. Për më tepër, 40% e kompanive që deklarojnë se do të ripërdorin shërbimet online, shprehen se do ndryshojnë planet e investimeve duke i përqendruar në drejtim të shërbimeve online, specifikisht në teknologji të reja, menaxhimin e rriskut dhe forcimin e kanaleve të shitjes me pakicë. Në të ardhmen, vlerësohet një analizë e mëtejshme në lidhje me llojet e shërbimeve online që janë përdorur më shumë nga biznesi.
- Situata rezulton problematike për sa i përket egzistencës së planeve të emergjencës, ku **86% e kompanive deklarojnë se nuk kanë plan të aprovuar emergjence**. Sjellja është e njëjtë pavarësisht nga madhësia apo sektorit ekonomik (shërbimi dhe industria duket se janë më të përgatitur).

III. Metodologjia

Qëllimi i Anketimit

Anketimi mbi "**Vlerësimin e Ndikimit të Pasojave që Rrjedhin nga Pandemia COVID19 mbi Aktivitetin e Biznesit në Shqipëri**" është një iniciativë e Sekretariatit të KI në bashkëpunim me MFE. Ky sondazh synon evidentimin e informacionit në lidhje me efektet e mundshme të pandemisë COVID19 në aktivitetet e biznesit.

Që nga viti 2015, Sekretariati i KI vazhdimisht ka ndërmarrë anketime me qëllim hartimin e analizave dinamike për vlerësimin e masave fiskale dhe anti-informalitet në klimën e investimeve në vend. Gjetjet e sondazheve janë gjithmonë objekt diskutimi në mbledhjet e Këshillit të Investimeve. Rekomandimet e miratuara nga Këshilli i Investimeve i paraqiten qeverisë shqiptare për analiza të mëtejshme, proces i cili pritet të sjellë ndryshime ose rishikime të mundshme ligjore dhe rregullatore me ndikim në klimën e investimeve.

Struktura e Pyetësorit

Pyetësori përmban 20 pyetje të hapura dhe të mbyllura. Pyetjet u formuluan nisur nga situata e paprecedentë e krijuar në vend nga përhapja e COVID19 dhe implikimet e mundshme të tij në aktivitetin e biznesit në Shqipëri, si edhe implikimet kryesore që rrjedhin nga bllokimi ekonomik e social në shumicën e vendeve të botës. Informacioni është strukturuar si më poshtë:

- **Informacion i Përgjithshëm**

Ky seksion përmbledh informacion mbi natyrën e kompanisë, sektorin kryesor ku operon, zonën gjeografike dhe të dhëna të madhësisë së saj (xhiron vjetore dhe numrin e të punësuarve)

- **Ndikimi i COVID19 në aktivitetin e biznesit**

Ky seksion përmbledh informacion në lidhje me implikimet e COVID19 në aktivitetin e bizneseve, pritshmëritë për xhiron vjetore dhe problemet e shfaqura.

- **COVID19 dhe Importet**

Ky seksion përmbledh informacion mbi efektet e mundshme të situatës së pandemisë mbi për bizneset e varura nga importet .

- **Sfidat e COVID19**

Ky seksion përmbledh informacion mbi mënyrat e organizimit të punës për shkak të kufizimit të lëvizjeve të njerëzve dhe të mjeteve të transportit, si edhe pritshmëritë e biznesit mbi kohëzgjatjes e efekteve të COVID-19.

- **Përgjigja e Qeverisë Shqiptare ndaj COVID19**

Ky seksion përmbledh vlerësimin e kompanive për mënyrat dhe masën e mbështetjes nga ana e qeverisë për zbutjes e pasojave nga masat anti-COVID19.

- **COVID19 dhe shërbimet online**

Ky seksion përmbledh informacion mbi përdorimin e shërbimeve online nga kompanitë dhe planeve për investime në këtë drejtim.

■ COVID19 dhe vazhdimësia e biznesit

Ky seksion përmbledh informacion mbi përgatitjen e kompanive për t'u përballar me situata të paparashikuara.

Pyetsori përfshin edhe një seri pyetjesh të hapura me qëllimin për të marrë një perceptim të drejtpërdrejtë të kompanive mbi problematikat me të cilat u ballafaquan gjatë pandemisë dhe propozimet e mundshme për zgjidhje bazuar në përvojën e tyre personale. *Të gjitha propozimet iu paraqitën Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për konsiderata të mëtejshme.* Një përmbledhje e propozimeve të biznesit sipas aktiviteteve ekonomike paraqitet në Shtojca.

Metoda e Shpërndarjes së Pyetësorit

Për të analizuar të dhënat, u zgjodh metoda e vrojtimit të thjeshtë me zgjedhje të rastit. Kampionimi i rastësishëm është forma më e pastër e probabilitetit ku secili anëtar i popullatës ka një shans të barabartë dhe të njohur për t'u zgjedhur.

Pyetsori u shpërnda nëpërmjet:

■ Website

Anketimi u krye tërësisht në internet përmes faqes zyrtare të KI, duke arritur një numër të përgjithshëm prej 4,800 shikimesh dhe një normë plotësimi² prej rreth 20%

■ Rrjeteve Sociale

Pyetsori u publikua në të gjitha rrjetet sociale të KI (LinkedIn, Facebook, dhe Twitter). Audiencia e arritur në Facebook ishte rreth 7,150.

■ e-mail

Një ftesë u dërgua me postë elektronike në rreth 8,000 kompani për të promovuar pjesëmarrjen në anketim. Një ftesë iu dërgua gjithashtu rreth 100 shoqatave / dhomave të biznesit për shpërndarje midis anëtarëve të tyre.

Metoda për mbledhjen e të dhënave

Për mbledhjen e të dhënave u përdorën pyetsorë online, si metoda me kosto më efektive si edhe për të arritur maksimumin e kompanive. Të dhënat u mbledhën online dhe në mënyrë anonime


² Pyetsorë të plotësuar/numri total i shikimeve

IV. Kampioni

Pyetesorit iu përgjigjën 833 kompani. Kampioni përfshin kompani të shpërndara në të 12 qarqet e Shqipërisë. Sipas INSTAT, 33% e ndërmarrjeve operojnë në Qarkun e Tiranës, 13% veprojnë në Qarkun Fier, ndërsa në Qarkun Korçë operojnë rreth 9% e totalit të kompanive, ndjekur nga Durrësi dhe Elbasani me respektivisht 7%, dhe 7%. Pjesa tjetër operon në qarqet e mbetura.


Ndër 833 ndërmarrjet e anketuara, 34% operojnë kryesisht në Qarkun e Tiranës, 15% në Qarkun e Durrësit të ndjekur nga Berati, Vlora dhe Korça sipas grafikut të mëposhtëm

Figura 1. Shpërndarja e Kampionit sipas qarkut




Sipas xhiros vjetore, 55% e të anketuarve janë kompani me xhiro mbi 14 milion lekë, ndërsa 45% janë kompani me xhiro vjetore deri në 14 milion lekë, sipas grafikut më poshtë

Figura 2. Shpërndarja e Kampionit sipas xhiros vjetore




Nga 833 ndërmarrjet e anketuara, 37% janë kompani me deri në 4 të punësuar, ndërsa pjesa tjetër janë kompani me më shumë se 4 të punësuar sipas grafikut të mëposhtëm

Figura 3. Shpërndarja e kampionit sipas të punësuarve



Sipas INSTAT, 65% e kompanive operojnë në sektorin e shërbimeve, kryesisht në tregti. Përbërja e kampionit është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

Figura 4. Shpërndarja e Kampionit sipas aktivitetit ekonomik



Eksportuesit përbëjnë 27% të kampionit.


V. Rezultatet e Anketimit

Ndikimi i COVID19

COVID-19 ka ndikuar negativisht bizneset në çdo sektor të ekonomisë. Turizmi dhe sektori i Shërbimeve janë ndikuar më negativisht


Pyetjes "Si e vlerësoni ndikimin e COVID19 në aktivitetin tuaj?", rreth 97% e kompanive iu përgjigjën se COVID19 ka ndikuar negativisht ose shumë negativisht në aktivitetin e tyre. Eksportuesit gjithashtu presin të ndikohen negativisht; 62% e eksportuesve deklaruan se do të ndikoheshin shumë negativisht nga pandemia.

Figura 5. Impakti i COVID19 në aktivitetin e biznesit



Sektori i shërbimeve dhe sektori i turizmit kanë përqindjen më të lartë të përgjigjeve me “ndikim negativ / shumë negativ”.


Figura 6. Impakti i COVID19 sipas aktivitetit ekonomik



COVID-19 detyroi pothuajse gjysmën e ekonomisë shqiptare të mbyllej


Pyetjes “A e ndërpretë aktivitetin tuaj si rezultat i COVID19?”, 47% e kompanive iu përgjigjës se ndaluan së punuari; 42% vazhduan punën pjesërisht dhe pjesa tjetër, 11% nuk e ndërprejnë aktivitetin e tyre, pavarësisht situatës.

Figura 7. Mbyllja e aktiviteteve gjatë COVID-19



Sektorë të ndryshëm patën sjellje të ndryshme kundrejt COVID19. Arsyet e mbylljes lidheshin kryesisht me vendosjen e masave izoluese anti-COVID-19 që autoritetet ndërmorën në të gjithë territorin e vendit.

Figura 8. Mbyllja e aktiviteteve gjatë COVID19 sipas sektorëve të ekonomisë




Akomodimi, aktivitetet e zinxhirit ushqimor dhe agjensitë e udhëtimit / operatorët turistikë, të lidhur me sektorin e turizmit janë më të prekur nga situata COVID-19, ashtu sikundër pritej për shkak të kufizimeve të qeverisë ndaj aktivitetit të tyre. Kështu, 94% e aktivitetit të turizmit ndaloi punën plotësisht ose pjesërisht. Në të kundërt, sektori i bujqësisë deklaron se është më pak i prekur nga situata e jashtëzakonshme, me specifikisht 24% të kompanive të cilët nuk e ndaluan aktivitetin dhe 57% të cilat pjesërisht e vazhduan aktivitetin.

COVID-19 uli në mënyrë drastike pritshmëritë e kompanive përsa i përket xhiros së tyre vjetore - më shumë se 80% e tyre presin ulje më shumë se 20%


Xhiro vjetore e kompanive do të ndikohet nga situata pandemike COVID-19 për shkak të mbylljes së aktivitetit dhe masave të qeverisë për të rritur sigurinë e jetës. Por pyetjes "Si e vlerësoni ndikimin e COVID19 në të ardhurat (xhiron) e kompanisë tuaj?" 80% e kompanive u përgjigjën se janë të sigurta që qarkullimi vjetor i tyre do të bjerë më shumë se 20%. Vetëm 3% e tyre besojnë se situata e krijuar nuk do të ketë ndikim në të ardhurat e tyre, kryesisht Tregtia.

Figura 9. Pritshmëritë e kompanive mbi të ardhurat vjetore




Kompanitë me një qarkullim vjetor deri në 14 milion lekë vlerësojnë një humbje më të madhe për shkak të situatës pandemike në krahasim me kompanitë me qarkullim më të madh se 14 milion lekë.

Figura 10. Prishmëritë e kompanive mbi të ardhurat vjetore sipas xhiros vjetore



Në përgjithësi konvergjojnë pritshmëritë e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë mbi uljen e të ardhurave vjetore edhe pse në masë të ndryshme. Shumica e kompanive që operojnë në turizëm dhe tregti besojnë se do të përjetojnë ulje më shumë se 20% të të ardhurave; ndërsa vetëm në bujqësi (57%) paraqitet në nivel më pak negativ kundrejt uljes së të ardhurave sikundër tregohet në grafikun vijues.

Figura 11. Prishmëritë e kompanive mbi të ardhurat vjetore sipas sektorit ekonomik




COVID-19 Implikimet ndaj biznesit

Për shkak të pandemisë COVID-19, kompanitë u përballën me sfida unike

Kufizimi i veprimtarive të biznesit, distancimi shoqëror dhe masat e tjera që qeveritë morën në të gjithë botën krijuan disa sfida jo të zakonshme për biznesin. Kur u pyetën "Cilat janë tre problemet më kryesore me të cilat po ndeshet aktualisht kompania juaj?" shumica e kompanive u përgjigjën se Mungesa e klientëve, Mungesa e likuiditetit, dhe Vështirësitë në pagesat e pagave ishin problemet më sfiduese, sipas grafikut më poshtë:

Figura 12. Sfidat përballë COVID-19



Mungesa e klientëve dhe Mungesa e likuiditetit për shkak të shfaqjes së COVID19, u kthyen në çështjet më problematike me të cilat u përballën të gjitha kompanitë pavarësisht madhësisë së tyre. Nga ana tjetër, vështirësitë në përmbushjen e detyrimeve tatimore ishin më sfiduese për kompanitë e vogla, ndërsa kompanitë e mëdha kishin vështirësi në pagesën e pagave. Sipas madhësisë, sfidat me të cilat u përballën kompanitë janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

Figura 13. Sfidat përballë COVID-19 për kompanitë me xhiro deri 14 Mil ALL





Figura 14. Sfidat përballë COVID-19 për kompanitë me xhiro mbi 14 Mil ALL



Sektorë të ndryshëm kanë gjetur mënyra të ndryshme për sigurimin e vijimësisë së biznesit të tyre. COVID19 i vuri përballë disa sfidave të cilat në një situatë normale kompanitë nuk do t'i përjetonin. Përgjithësisht, problemet me të cilat u përballen kompanitë gjatë periudhës pandemike janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

Figura 15. Sfidat përballë COVID-19 të sektorit Bujqësor




Figura 16. Sfidat përballë COVID-19 të sektorit të Ndërtimit




Figura 17. Sfidat përballë COVID-19 të sektorit të Tregtisë




Figura 18. Sfidat përballë COVID-19 të sektorit të Industrisë




Figura 19. Sfidat përballë COVID-19 të sektorit të Turizmit





Figura 20. Sfidat përballë COVID-19 të sektorit të Shërbimeve




Për shkak të situatës së jashtëzakonshme COVID-19, kompanitë (52%) në Shqipëri, kryesisht në industri, hasën probleme me furnizimin e lëndëve të para nga importet, ndërsa disa prej tyre po konsiderojnë burimet e brendshme si një opsion

Kur u pyetën "A keni hasur probleme me furnizimin me mallra dhe lëndë të parë nga importi?", 52% e kompanive u përgjigjën se janë përballur me problematika. Megjithatë kufijtë doganorë tregtarë gjatë COVID-19 nuk u mbyllën dhe lejonin tregtinë sidomos të mallrave, probleme u krijuan për shkak të protokolleve të rrepta që të gjithë transportuesit duhet të respektonin kur kalonin nga një vend në tjetrin.


Në vijim, pyetjes "Nëse po, a ndikojnë këto mungesa në vijimësinë e veprimtarisë suaj në biznes?", 69% e kompanive deklaruan se biznesi i tyre mund të dëmtohet seriozisht për shkak të problemeve pasi ato varen plotësisht nga importet. Ndërkohë, 31% deklarojnë se po mendojnë të zëvendësojnë importet pjesërisht apo plotësisht. Më specifikisht, vetëm 3%, 4% dhe 2% e ndërmarrjeve që operojnë përkatësisht në Tregti, industri dhe Shërbime deklaruan se mund të zhvendosen plotësisht nga importi drejt burimeve vendase për të siguruar vazhdimësinë e biznesit.

Figura 21. Varësia ndaj Importeve



Sipas përgjigjeve të kompanive, problemet më të shumta u krijuan me importet nga vendet e BE. Duke krahasuar të dhënat nga sektorë të ndryshëm, vërehet se degë të caktuara të ekonomisë së vendit varen shumë nga importet. Ashtu si pritej, përgjigjet e kompanive konfirmojnë varësinë më të madhe të sektorit të Industrisë (83% e kompanive deklarojnë se varen plotësisht nga importet), ndërsa sektori i ndërtimit është më pak i varur nga importet (29% e kompanive deklarojnë se varen plotësisht nga importet).

Figura 22. Varësia ndaj Importeve sipas sektorëve të ekonomisë




Për shkak të pandemisë COVID-19, rutina klasike e punës ndryshoi në mënyrë drastike dhe bizneset nuk ishin të përgatitur se si të reagonin

Koronavirusi i ri po ndryshon rrënjësisht mënyrën e të punuarit theksojnë raporte të ndryshme ndërkombëtare. Rutina klasike e punës për shumicën e vendeve të punës u sfidua seriozisht nga situata pandemike. Shumë kompani nuk dinin si të reagonin në adresimin e pamundësisë së punëtorëve të tyre për t'u paraqitur në vendin e tyre të punës.

Kur u pyetën "Cfarë masash ndërmori kompania juaj për të adresuar mungesën e fuqisë punëtore?", 37% deklaruan se nuk morën asnjë masë.


Figura 23. Masa për adresimin e problemeve të punës gjatë COVID-19



Pavarësisht nga madhësia, shumica e kompanive nuk mundën të merrnin asnjë masë për të adresuar problemet që lindin me pamundësinë e punëtorëve për t'u paraqitur në punë. Kompanitë me xhiro mbi 14


milion lekë deklaruan se kanë larguar punonjës si masë për të përballuar problemet që lindën. Kompanitë e vogla në anën tjetër kryesisht lejuan punën nga shtëpia. 9% e kompanive që kishin zgjedhur "Tjetër" si opsion, më së shumti tregojnë se janë të vetëpunësuar ose biznes familjar.

Figura 24. Masat për adresimin e problemeve të punës gjatë COVID-19 sipas madhësisë



Në varësi të karakteristikave specifike të vendeve të punës, sipas sektorëve të ndryshëm, largimet nga puna u zbatuan kryesisht nga industria (30%), turizmi (30%) dhe shërbimet (28%); ndërsa puna në distancë nga shtëpia u përdor kryesisht nga Shërbimet (66%).


Figura 25. Masa për adresimin e problemeve të punës gjatë COVID-19 sipas sektorëve



COVID-19 është kërcënim serioz ndaj vijimësisë së biznesit


Për shkak të pasojave që rrjedhin nga situata e paprecedentë, për të siguruar vazhdimësinë, biznesi duhet të reagojë dhe të garantojë burimet e nevojshme financiare. Në përgjigje të pyetjes "Cilat janë masat që do të ndërmerreni për të siguruar vazhdimësinë e biznesit tuaj?" kompanitë u ndanë midis burimeve si "të ardhurat vetjake të akumuluar", "shkurtimet të shpenzimeve" ose "kreditë bankare".

Figura 26. Masa për të siguruar vijimësinë e biznesit



Vetëm 4% e kompanive besojnë se nuk do të përballen me ndonjë problem për shkak të COVID-19, 51% e të cilave operojnë në Shërbime, 25% operojnë në Tregti dhe 11.4% veprojnë në Turizëm. 7% e kompanive që zgjedhën "Tjetër" si opsion tregojnë se do të presin pa ndërmarrë asnjë masë, ose do të marrin borxh para nga miqtë e tyre ose do të presin vendimet e kompanisë mëmë.


Figura 27. Masa për të siguruar vijimësinë e biznesit sipas sektorit ekonomik



Kompanitë me të ardhura mbi 8 milion lekë do të ulin kostot për të siguruar vazhdimësinë e biznesit të tyre. Kompanitë me qarkullim deri në 8 milion lekë do të përdorin të ardhura të akumuluar për të siguruar vazhdimësinë e biznesit.


Kur u pyeten "Sa mendoni se do të zgjasin efektet negative të COVID19 në veprimtarinë tuaj?", biznesi ka pothuajse të njëjtat pritshmëri.

Figura 28. Kohëzgjatja e ndikimit të COVID19



Pavarësisht nga madhësia, shumica e ndërmarrjeve vlerësojnë se ndikimi COVID19 do të zgjasë deri në 1 vit. Sipas sektorëve të ekonomisë, ndërtimi, tregtia, turizmi, shërbimet dhe industria vlerësojnë se ndikimi COVID19 do të zgjasë deri në 1 vit, vetëm Bujqësia vlerëson një ndikim deri në 6 muaj.

Figura 29. Kohëzgjatja e ndikimit të COVID19 sipas sektorëve të ekonomisë




Ndërhyrjet e Qeverisë

COVID-19 vërtetoi se mbështetja e qeverisë është e pazëvendësueshme në situata të panjohura për të siguruar vazhdimësinë e biznesit

Shumica e qeverive nëpër botë, pasi siguruan kushtet shëndetësore, u përqëndruan tek bizneset dhe nevojat e tyre të menjëhershme për të mos lejuar kolapsin e ekonomisë. Paketa e parë financiare e qeverisë shqiptare u komunikua në 19 Mars 2020, ndërsa e dyta u komunikua më 13 Prill 2020. Në këtë anketë (28 Mars – 6 Maj) kompanitë vlerësuan masat financiare të paketës së parë.

Kur u pyeten " *Cilat nga masat e prezantuara nga qeveria mendoni se do të kenë ndikimin më pozitiv tek minimizimi i efekteve negative?*", përgjithësisht kompanitë konvergojnë në mendimet e tyre, ndërsa duke analizuar përgjigjet sipas sektorit dhe madhësisë, përgjigjet ndryshojnë sipas grafikut të mëposhtëm.

Figure 30. Vlerësimi mbi masat qeveritare në adresim të COVID19



Tjetër pamje shfaqet nëse krahasojmë përgjigjet sipas madhësisë së kompanive. **Kompanitë mbi 14 milion lekë vlerësojnë se pagesa e kredive do të ketë ndikimin më pozitiv**; ndërkohë biznesi me qarkullim **deri në 14 milion lekë vlerëson se mbështetja financiare për punonjësit do të ketë një ndikim pozitiv**.

Grafikët e mëposhtëm tregojnë vlerësimin e efektivitetit të masave qeveritare sipas **sektorëve të ekonomisë**.

Figura 31. Vlerësimi mbi masat qeveritare në adresim të COVID19 sipas Bujqësisë




Figura 32. Vlerësimi mbi masat qeveritare në adresim të COVID19 sipas Ndërtimit




Figura 33. Vlerësimi mbi masat qeveritare në adresim të COVID19 sipas Tregtisë




Figura 34. Vlerësimi mbi masat qeveritare në adresim të COVID19 sipas Industrisë




Figura 35. Vlerësimi mbi masat qeveritare në adresim të COVID19 sipas Turizmit





Figura 36. Vlerësimi mbi masat qeveritare në adresim të COVID19 sipas Shërbimeve




COVID19 -Teknologjia dhe biznesi

COVID-19 ndërgjegjësoi kompanitë mbi efikasitetin e shërbimeve online

Shqipëria renditet ulët në treguesit e konkurrencës së inovacionit, por COVID-19 do të ndikojë duke rritur përdorimin dhe investimet e kompanive në teknologji të reja dhe shërbime online.

Kur u pyetën "A i keni përdorur shërbimet elektronike në këtë periudhë?", 75% e kompanive deklaruan se kanë përdorur shërbimet online. Është e paqartë, cilat shërbime online përdorën pasi pyetjet e pyetsorit nuk specifikuan shërbimet, por rezultatet treguan se kompanitë mendojnë se shërbimet në internet janë shumë të dobishme dhe kanë potenciale. Më tej, kur u pyetën "Nëse po, a mendoni se do t'i përdorni edhe në të ardhmen?", rreth 81% e kompanive pranuan se do t'i ripërdorin ato në të ardhmen.

Figura 37. Përdorimi i shërbimeve online



Kompanitë u pyetën gjithashtu rreth planeve të tyre të ardhshme për investimet në internet. Përgjigja e pyetjes "Në të ardhmen, a mendoni se do të ndryshojnë planet tuaja të investimit, drejt ofrimit të shërbimeve online?" kishte gjithsej 38% përgjigje pozitive.

Figura 38. Planet e ardhshme për investime në Inovacion






Figura 39. Planet e ardhshme për investime në Inovacion sipas madhësisë



Vetëm 36% e kompanive me qarkullim mbi 14 milion ALL, dhe 40% e kompanive me qarkullim deri në 14 milion ALL do të ndryshojnë planet e tyre të investimeve drejt shërbimeve online, veçanërisht kompanitë që operojnë në sektorin e shërbimeve. Investimet do të përqendrohen kryesisht në teknologji të reja (përgjigjet për pyetjen " Nëse po, investimet do të fokusohen drejt:" jepen në grafikun e mëposhtëm).

Figura 40. Fokusi i investimeve të ardhshme




Plani i emergjencës

COVID-19 vërtetoi që kompanitë shqiptare janë seriozisht të papërgatitur për të përballuar situata të paparashikuara

Kompanitë në Shqipëri nuk kanë plan emergjence (86% e kompanive nuk kanë plan të aprovuar emergjence). Sjellja është e njëjtë pavarësisht nga madhësia apo sektori ekonomik. Kompanitë që operojnë në Shërbime dhe industri janë më të përgatitur për t'u përballur me raste emergjence, megjithëse në nivele shumë të ulta (17% e kompanive të shërbimit dhe 16% e ndërmarrjeve industriale deklarojnë se kanë një plan emergjence të miratuar). Kompanitë e ndërtimit dhe tregtisë janë më pak të përgatitur.

Figura 41. Ekzistenca e Planeve të Emergjencës



Shtojca

Përmbledhje e sugjerimeve, në përgjigje të COVID19, të grupuara sipas sektorëve të ekonomisë dhe niveleve të qeverisjes.

Shtojca 1 – Masat e sugjeruar nga Sektori i Bujqësisë

I. Qeveria Qëndrore

Fushat e Ndërhyrjes	Masat e Sugjeruara për Qeverinë Qendrore
TAKSIM & TARIFIM	Ulje të taksës së pronës për magazinat e ruajtjes së bimëve mjeksore, duke qenë se janë produkte me volum të madh dhe kërkojnë shumë hapësira magazinuese. Kërkojme ulje të kësaj takse të paktën deri në 50%. Dhenia e lejeve të ndërtimit në mënyrë të përshpejtuar dhe pa burokraci të tepërta për ata që ndërtojnë kapanone magazinimi të bimëve mjekësore, për ata grumbullues të cilët kanë hipotekë të rregullt për truallin mbi të cilin do të ndërtohet. Miratimi i kësaj leje të jetë brenda 15 ditëve dhe taksa e lejes së ndërtimit të mos jetë mbi 1 Eur/m ² .
	Tatimi atipik prej 6% ne blerje me vetefaturim te lendes se pare (qumesh prej fermereve) dhe 20% ne shitje prej agro perupueseve te behet i njejte: 6% ne blerje 6% ne shitje//20% ne blerje 20% ne shitje ose shteti te rifinancoje diferencen prej 14% per kompanite agroperpunuese. Kjo mase do te cliroje likuiditete te cilat kompanite do te perdorin per zhvillim te kapaciteteve te tyre.
	Heqja e akcizës për prodhuesit vendas për një periudhë 1 vjecare.
	Anullim të ligjit për tvsh e inputeve bujqësore dhe rimbursim e fermerit për vlerën e tvsh të inputeve të blera sipas faturës.
	Rimbursim i TVSH të gjitha bizneseve exportuese sipas ligjit pra për bizneset që shitjet i kane më shumë se 70% exporte të behet rimbursim brenda 30 ditëve nga data e kërkesës dhe të mos i nenshtrohen analizës së riskut por të klasifikohen me risk zero ashtu siç thotë dhe ligji pavarësisht se eksperiencia vërteton të kundërtën.
MOBILITET	Të mos pengohet dhe të inkurajohet grumbullimi i bimeve mjekësore (BM), pavarësisht situatës së vështirë që po kalohet. BM zënë vend të rëndësishëm në eksportet bujqësore të vendit tonë. Në situatën ku jemi në natyrë kanë filluar çelja e artikujve Lule për eksport. Grumbulluesit janë të tronditur dhe nuk po dalin pasi nuk janë te qarte se çfarë do të ndodhë. Vajtja individuale apo familjare nëpër kodra apo male për të grumbulluar BM nuk thyen ndonjë rregull për mbrojtjen nga Covid-19. Duke qenë se fillim te sezonit nëse disa bime nuk mblidhen, nuk ka një moment të dytë për të plotësuar kontratat vjetore të klientëve dhe eksporti do të ulet në mënyrë të konsiderueshme për artikujt më të shtrenjtë. Orari i punës në ferma nuk ka pasur kufizime por përdërisa transporti i puntoreve dhe produkteve për në ara është i kufizuar ata nuk lejohen të lëvizin makinat dhe për këtë duhen hequr kufizimet. Sektor i BM ka nevojë urgjente për mbështetje financiare dhe për leje të posacme lëvizje.

	Leje për të lëvizur me mjete të kompanisë në të gjithë Shqipërinë dhe pa fasha orare.
SUBVENCIONE/INCENTIVA	Problemi i IPARD-fondeve të Bashkimit Europjan. Ka problem në klasifikimin e grupeve përfituese. Është vendosur kufiri i qarkullimit 2.40 mil euro për të përfituar nga këto skema. Ne propozojmë që ky limit të shkojë në 10 mil euro. Kjo, me qëllim që të mos diskriminohet kjo industri dhe mos të lërë hapësira për pagesa rryshfetesh, për të përfituar nga këto fonde. Rritja e fondeve nga AZHBR dhe grantet qeveritare në mbështetje të subjekteve që merren me kultivimet e bimëve mjeksore. Këtë vit kjo mbështetje ka qënë në nivelet më të ulta të 20 viteve të fundit. Fermerët që kultivojnë janë në kushte jo të mira ekonomike në këtë periudhë kultivimi i BM ka nevojë për disa shpenzime si për farëra , punime agroteknike , transport etj. Situata e pademise se Covid - 19 i ka gjetur të pa përgatitur financiarisht dhe ata nuk janë të sigurtë nëse duhet ti shpenzojnë ato pak te ardhura që kanë në fermë apo ti kenë për të mbajtur familjen. Në këto momente fermeri ka nevojë më shumë se kurrë për subvencionim.
	Stimulimi i mbjelljeve pranverore, përmiresimi i strukturës së mbjelljeve sipas biologjisë së bimëve.
	Përfshirje e të gjithë subjekteve qe operojnë në sektorin e bujqësisë në skemat e financiuara nga EU.
	Promovim i prodhimit vendas duke u përqëndruar tek: Bujqësia (pemtari, sera, perime, zarzavate, aroret, agrumet, portokalli, mandarina, limonat, ulliri, vreshtari sipas zonave Blegtori (mish dhe qumësht), etj.
	Subvencion direkt për kg të shitur të fermerit.
UNIFIKIM & KOORDINIM PROCEDURAL/OPERACIONAL	Hartimi i Projekt Ligjit Të Urdhërit Profesional të Agronomit Shqipëtar duke ulur normativën e mbulimit që kanë sot që është fiktive.(2300 fermerë për agronom)
	Mundësia e mbështetjes me literaturë e teknologji për kultivimin e bimëve antivirusale dhe bimësisë që forcon sistemin imun në fermë.
SEKTORI BANKAR & BANKA QENDRORE	Shtyrjen e afatit të pagesës së kësteve të kredive për ato subjekte që momentalisht janë në periudhë grace, por pas disa muajsh fillojnë me pagesën e kësteve të plota të kredisë.
	Problematika lidhur me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit- Bimët Mjekësore trajtohen si lëndë drusore dhe për këtë arsye kërkohen leje të veçanta dhe të kushtueshme dhe jepen penalizime transportuesve të bimëve të egra.
	Në një bashkëpunim midis AMAP, Ministrisë së Bujqësisë dhe Inspektoriatit Shtetëror, të hartohet një plan për kontrollin dhe kufizimin e pesticideve që futen në vendin tonë. Përdorimi pa kontroll i këtyre pesticideve, po shkatërron prodhimin dhe po ul mundësite tona për të konkurruar në tregun botëror. Të kontrollohen të gjitha stoqet e farmacive bujqësore menjëherë, të asgjësohen të gjitha sasitë e inputeve të pa lejuara që janë gjendje në magazinat e farmacive bujqësore. Të gjendet burimi dhe shkaktarët e futjes në treg të pesticideve të ndaluara dhe të merren masa në mënyrë që të ndërpritet abuzimi në të ardhmen. Të krijohet strukturë e veçantë aktive pranë drejtorive

KOORDINIM I STRATEGJIVE DHE PLANEVE TE VEPRIMEVE	bujqësore për këshillim dhe kontroll në përdorimin e pesticideve në prodhimin bujqësor duke kufizuar aktivitetin vetëm në këshillimin e fermerëve dhe kontrollin e farmacive për të evituar keqpërdorim të inputeve por pa pasur attribute për të marrë masa administrative të gjobave.
---	---

II. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Fusha e Ndërhyrjes	Masat e sugjeruara për qeverinë qendrore
TAKSIM & TARIFIM	- Të shtyhen pagesat e taksava vendore përtej afateve ligjore të lejuara. - Reduktim i të gjitha taksave vendore të viteve 2020, 2021 në masën 50 % ose bërjen e taksava lokale zero për 2020. - Qeveria vendore të pezullojë taksat e gjelbërimit e të pastrimit. - Ulje të taksës së pronës edhe taksës së territorit për 6-12 muaj.
UNIFIKIM & KOORDINIM PROCEDURAL/OPERACIONAL	Disinfektimi i ambjenteve të jashtme në biznese. Tenderi i grumbullimit që mbahet nga bashkitë të jetë i hapur. Lejimi i më shumë se një operatori që të ketë të drejtën e grumbullimit, për zonë. Në këtë mënyrë pengohet diskriminimi i grumbulluesve të vegjël dhe evitohet monopolizimi i zonave.

Shtojca 2 - Masat e sugjeruar nga Sektori i Ndërtimit

I. Qeveria Qendrore

Fusha e ndërhyrjes	Masat e sugjeruara për qeverinë qendrore
TAKSA	- Ndërprerja e tatim fitimit parapagim të paguhet deri sa është xhiroja deri në këtë moment jo mbi bazën e parashikimit nga viti I kaluar; - Shtyrja e kësteve të tatim-fitimit në 6 mujorin e dytë të vitit 2020; - Reduktim i normës së tatim fitimit me 5-10% për vitin 2020-2021 Hegja e gjobave dhe interesave që rrjedhin si pasojë e jo pagesës në kohë e detyrimeve tatimore. T'u kthehet TVSH bizneseve që kanë tvsh për tu rimbursuar. Ulje në 5% tatimin mbi Dividentin për vitin 2020.
MOBILITET	Të mos pengojë lëvizjen ndërqytetase për punëtorët dhe furnizimet me materiale ndërtimi.
UNIFIKIM & KOORDINIM PROCEDURAL/OPERACIONAL	Mos të pengohen pagesat nga Thesari. Të rihapet një shërbim ekspres me sportel për biznesin në hipotekë pasi shërbimet online kanë shumë vonesa.
SEKTORI BANKAR & BANKA QENDRORE	Kredi bankare me 0%.
KOORDINIM I STRATEGJIVE & PLANEVE TE VEPRIMIT	Konkurenca e ndershme në punët publike ku ne mund të gjejmë punë sipas kapaciteteve tona.
MBESHTETJE PER PUNONJESIT	Pagesë e punëtorëve deri në 80 % nga qeveria.

II. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Fusha e ndërhyrjes	Masat e sugjeruara për qeverinë qendrore
TAKSIM & TARIFA	Pagesa e taksës të pasurisë të bëhet me këste pa penaltete deri në fund të vitit
LIKUIDITET	Tu likuidojnë bizneseve që kanë bërë punime faturat brenda 30 ditëve.
KOORDINIM I STRATEGJIVE & PLANEVE TE VEPRIMIT	Lehtësimin e kushteve për pajisje me Leje ndërtimi dhe Licenca për aktivitetin ndërtimor. Mirëmbajtje për hapësirat publike që i jepen për përdorim biznesit.
MBESHTETJE PER PUNONJESIT	Programe sociale për punonjësit, psh programe afatshkurtëra punësimi

Shtojca 3 - Masat e sugjeruar nga Sektori i Industrisë

I. Qeveria Qëndrore

Fushat e ndërhyrjes	Masat e sugjeruara për qeverinë qendore
TAKSIM & TARIFIM	Kompanitë nuk duhet të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të paktën deri në fund të vitit 2020.
	- Ulje në 5% Tatimin mbi Dividentin për vitin 2020; - Zerimi i përqindjes së tatimit mbi dividendin.
	Të mos paguhet parafitimi i tatim fitimit për vitin 2020.
	Rimbursim pa kërkesë automatikisht të TVSH-së që është gjendje në llogarinë e subjektit që kanë TVSH gjendje të kreditueshme sidomos subjekteve prodhuese për eksport sipas deklaratës së fundit të muajit mars 2020.
	Të rishikohen taksat doganore për importet
	Heqja e akcizës për prodhuesit vendas për një periudhë 1 vjeçare.
	- Heqja e tatim fitimit për një periudhë 1 vjetore. - Heqja e tatimit në burim për ambientet me qera. - Ulja e TVSH nga 20% për produktet ushqimore në 10%.
	- Të ulet akciza e naftës që të ulet kostoja e bizneseve. - TVSH e naftës të njihet si tvsh e zbriteshme.
MOBILITET	Zgjidhjen e problemit të lëvizjes së punonjësve jashtë Shqipërisë kryesisht në Maqedoni e Veriut, Mali i zi.
SUBVENCIONIM/INCENTIVIM	Subvencionim i pagës për orët e papunuara (normalisht punohet vetëm 5 orë).
	Ne kushtet e Shqipërisë, ku kemi bilanc negative tregetar, shteti të aplikojë paketa stimuluese/grante për bizneset eksportuese, duke financuar deri 50% të kostove për gjithë eksportet e periudhës 2020-2021.
	Sa i përket sektorit të prodhimit të verës, për rimbursimim e akcizes sugjerjmë të rritet maksimum për verën e importit 200 lekë të reja/litri ndërsa për verën e vendit, kjo shifër të jetë por të rimbursohet parapagim - kjo ndodh në Kosovë. Kjo është politikë e mbrojtjes së produktit vendor.
	Programe punësimi të nxitura nga qeveria.
UNIFIKIM & KOORDINIM PROCEDURASH/OPERACIONAL	Ne jemi një kompani që operojmë me agjentë shitjesh dhe në çdo ndryshim apo adoptim të masave punonjësit përballen me interpretimin e punonjësve të rendit anë e mbanë vendit.
SEKTORI BANKAR & BANKA QENDRORE	Programe punësimi të nxitura nga qeveria.
	- Kredi immediate nga bankat e nivelit të dytë në formën e overdraftit, në vlerën 1/6 deri në 1/5 e xhiros së deklaruar të vitit 2019; - Normat e interesit të mos kalojnë vlerën 3% dhe të jenë të garantuara nga fondi sovran.
	Qeveria sa të mundet të bashkëpunojë me qeverinë e Kosovës për të lehtësuar lëvizjen e mallrave për Kosovë vetëm me faturë pa dogana.

KOORDINIM STRATEGJISH E PLANE VEPRIMI	Qeveria nuk duhet të heqë fokusin nga investimet e reja.
	Sugjeroj që ekonomistët dhe juristët më të mirë duhet të jenë ekipi i cili duhet të sugjerojë qeverisë zgjidhjet optimale duke bërë një analizë të thelluar dhe transparente të situatës ekonomike, dhe rishikim të buxhetit si dhe një bashkëpunim me bankat e nivelit të dytë të cilat fatmirësisht kanë likuiditet. Është shumë e rëndësishme që ekipi të jetë teknik jo politik.
MBËSHTETJE PËR PUNONJËSIT	Suvencionim i pagave të personelit jo aktiv pa patur limit xhiroje për kompaninë.
	Sigurimi i testimit të personelit që rikthehet të punojë në mënyrë për të përcaktuar kush duhet dhe kush nuk duhet të kthehet në punë.
LIKUJDITET	Ngritja e një fondi për garantimin e jetës së qytetarëve pagës së tyre dhe pensionin social minimal nga çdo lloj fatkeqësisë shoqërore, natyrore dhe mbrojtjen intelektuale si asete kombëtare.
	Duhet ndërhyrë me politika monetare për të rritur fuqinë blerëse.

II. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Fushat e ndërhyrjes	Masat e sugjeruara për qeverinë qendrore
TAKSIM & TARIFIM	■ Heqjen e taksave vendore për vitin 2020; ■ Shtyrjen e likuidimit të taksave vendore në tremujorin e tretë të vitit.
	Të ulë taksën e pasurisë për kapanonet industriale, si dhe taksat e tjera që rëndojnë biznesin për një periudhë 6 mujore.
	Të hiqet taksa për arsimin si taksa më e pa drejtë e vendosur prej kohësh dhe arsimi nuk perfiton asgjë nga kjo takse.
MOBILITET	Rrjeti i transportit urban funksional dhe i modifikuar kundrejt rregullave sanitare. Dezinfektim sistematik në orët e bllokimit të rrugëve.
MBËSHTETJE PËR PUNONJËSIT	Ndihma sociale për të larguarit nga puna në nivel lokal.

Shtojca 4 – Masat e sugjeruar nga Sektori i Turizmit

I. Qeveria Qendrore

Fushat e ndërhyrjes	Masat e sugjeruara për qeverinë qendrore
TAKSA	- Bizneset nuk duhet të paguajnë tatim fitim për 2019 në mënyrë që të kenë disa rezerva për të mbajtur kompanitë në këmbë për 2020-2021; - Të anulohet pagesa e tatim fitimit të paralogaritur me përafërsi; - Reduktim i normës së tatim fitimit me 5-10% për vitin 2020-2021.
	- Perjashtimi i taksës hyrëse për të gjithë turistët e huaj; - Rishikim i tarifave aeroportuale.
	- Mos aplikimi i gjobave dhe kamatvonesave për mos likuidimin në kohë të kontributeve të sigurimeve shoqërore, tatim mbi burim, tatim fitim, etj; - Miratim nga qeveria të një amnestie penale (fshirje gjobash për deklarim te vonuar).
	Ulja e tatimit të qerasë.
	Hegjja e akcizes për prodhuesit vendas për një periudhë 1 vjeçare dhe taksës së qarkullimit për transportin publik.
	Ulja e TVSH, për transportin në 6%.
MOBILITET	Paketë instruksionesh të studiuar nga ekspertë sesi mund të bëhet hapja e sektorit akomodim/bar & restorante.
	Të sigurohet hapja e biznesit të paktën në kapacitetin 50%.
	Hapja e kufijve.
SUBVENCIONE/INCENTIVA	Rritje e fondeve dhe granteve për sektorin e turizmit.
	Qeveria duhet të subvencionojë pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të bizneseve të turizmit për 2020. Edhe nëse në muajt në vijim situata do zhbllloket, le të shtyhet kjo pagesë për në vitin 2021.
UNIFIKIM & KOORDINIM PROCEDURAL/OPERACIONAL	- Lehtësimin e procedurave të e-Albania për të gjithë njerëzit; - Stop burokracive në përdorimin e e-albania (lehtësim në aksesim për lejet).
	Informacioni dhe analizimi i impaktit të situatës në sektorin e turizmit duhet të jetë i saktë dhe gjithëpërfshirës dhe jo i manipuluar nga interesat politike.
SEKTORI BANKAR & BANKA QENDRORE	Qeveria duhet të dalë garant në banka për t'i krijuar mundësi sipërmarrësit marrë kredi jetike me interes zero, për të kapërcyer mungesën e likuiditetit, të shtirë në kohë. Kështu investitorët do të kenë kurajë për të vazhduar punën.
	Shtyrje të pagesës së kredive ekzistuese të sipërmarrësve turistikë deri më 2021.
	Garancia sovranë të përdoret për të financuar me kapital qarkullues SME: - norma efektive e interesit të jetë midis 0.5% - 1.0%; - afati i maturimit të jetë deri 3 vite;

	c. shuma e financimit të jetë deri 30% e xhiros së vitit të fundit.
KOORDINIM TE STRATEGJIVE & PLANEVE TE VEPRIMIT	Promovim i bizneseve turistike pas pandemisë.
	- Mundësia për riskedulim të pagesave të faturave të energjisë elektrike; - Ulja e cmimit të energjisë për biznesin e madh minimalisht deri në çmimin standart të konsumatorit individual.
	Njohjen në bilancin vjetor të biznesit të të gjitha shpenzimeve në familjen time psh. si fatura pagese të shkollave të fëmijëve. Faturat e vizitave mjekësore fatura ilaçesh. etj që ka shumë për një familje dhe në këtë rast me anë të faturave të deklaruar nga unë psh kontrollohet dhe informaliteti në shërbimet që unë kam marrë.
	Anullimin e të gjitha PPP dhe vendosja e këtyre parave në buxhetin e shtetit për përmirësimin e sektorit të shëndetësisë dhe kreditimin e bizneseve të vogla.
	Referuar industrisë turistike: Qeveria duhet të ngrejë një sistem të besueshëm dhe transparent i cili provon që stuata në vend në lidhje me Covid19 është nën kontroll. Testime masive, ndjekje të shpejta të rasteve të infektimit, mjaftueshëm kapacitete venitimi në spitale etj etj. Vetëm kështu, turistët nga tregjet e targetuara dhe qeveritë e tyre do fillojnë të rikthehen në Shqipëri.
MBESHTETJE PER PUNONJESIT	- Subvencionimi i pagave për 6 muaj; ose - Pagesë e 50% të pagave të punonjësve për sezonin turistik deri në muajin Shtator; ose - Grante të pakthyeshme për pagat e punonjësve.
	Për punonjësit që kanë qënë nga rrethet si dhe nga Tirana dhe janë larguar nga puna për shkak të frikës por dhe për shkak se u mbyllën kufinj të të gjithë botën tu sigurohet një asistencë sociale deri në momentin që do të fillojë puna.
RRITJE TE KAPACITETEVE	Të përgatiten projekte përgatitje profesionale online për punonjësit.
LIKUIDITET	Te ndihmohemi për shlyerjen e borxhit të krijuar në këtë situatë ndaj agjensive turistike nga të cilat kishim marrë parapagesat e rezervimeve për grupet e anuluar.
	Qeveria duhet të injektojë likuiditet tek kompanitë.

II. Njësitë e Vetëqeverisjen Vendore

Fusha e ndërhyrjes	Masa të sugjeruara për qeverinë vendore
TAKSA	Qeveria vendore minimumi që mund të bëjë është të heqë taksën e shfrytëzimit të hapësirave publike ose minimumi ta zvogëlojë atë, pasi dihet që këto hapësira nuk do të shfrytëzohen normalisht nga ne dhe taksa është shumë e lartë edhe sikur të funksionojmë si çdo vit, gjithmonë e kemi shfaqur këtë shqetësim por askush nuk na ka dëgjuar.
	Të anullojë çdo lloj gjobe të marrë në vitin 2020.
	Falja e taksave vendore për vitin 2020 ose shtyrja e tyre për në 2021.
	Heqja e taksës mbi pasurinë e paluajtshme për 2 vite.
	Duhet të shtyhet për në vitin 2021 pagesa e taksave vendore.
UNIFIKIM & KOORDINIM PROCEDURAL/OPERACIONAL	Lehtësimin e kushteve për pajisje me Leje ndërtimi dhe Licenca për aktivitetin ndërtimor.
	Asistencë dhe Mirëmbajtje për hapësirat publike që i jepen për përdorim biznesit.
KOORDINIM TE STRATEGJIVE DHE PLANEVE TE VEPRIMIT	Promovim të turizmit të të gjitha llojeve. PR për thithjen e turistëve nga vende të ndryshme.

Shtojca 5 – Masat e sugjeruar nga Sektori Tregti

I. Qeveria Qendrore

Fushat e ndërhyrjes	Masat e sugjeruara për qeverinë qendrore
TAKSIM & TARIFIM	Të kalohet në një sistem tjetër pagese Tatim Fitimi për Biznesin e mesëm dhe të madh ku këstet të paguhen çdo 3 muaj në bazë të të ardhurave reale siç e ka Kosova dhe jo në bazë të kësteve.
	Të nxirret një akt normativ që të shtyhen me 6 muaj pagesa e qerave të lokaleve të marra me qera nga biznese që kanë reduktim të xhiros mbi 50% ose janë mbyllur fare dhe të hiqet tatimi në burim për këto pagesa.
	- Ulja e nivelit të TVSH nga 20% në 10%. - Ulja e tatimit mbi të ardhurat.
	Riskedulimi në 6 mujorin e dytë të vitit 2020 dhe në vazhdim, i pagesës së tatim-fitimit për të gjithë bizneset me të ardhura vjetore edhe për bizneset me xhiro mbi 14 milion lekë.
	Të shtyhet afati për fiskalizimin, në kushtet kur: - bizneset që kanë aktivitet në rritje, punojnë me staf të reduktuar dhe koha për implementimin e projekteve është e kufizuar - prioritet është plotësimi i nevojave të klienteve; - bizneset që kanë aktivitet në rënie përpiqen të minimizojnë kostot dhe përshtatja e sistemeve ekzistuese kërkon kosto shtese prej të cilave biznesi nuk ka asnjë përfitim afatshkurtër;
MOBILITET	Të mendohet dhe ulja e TVSH për produktet e shportës. Nga 20% në 6-7%.
	Qarkullimi i lire i automjete ndërmjet qyetetsh na lehtëson shumë duke respektuar gjithmonë higjenën.
SUBVENCIONIME/INCENTIVA	Të hapen baret dhe restorantet qoftë dhe me distanca të percaktuara dhe me orare të kufizuara.
	Subvencionim i qerasë.
	Pagesa e pagave, sigurimeve dhe tatimit mbi pagën edhe për stafet e kompanive që kanë mbi 50 punonjës në masën 80% (siç po bëjnë të gjitha shtetet e rajonit).
UNIFIKIM & KOORDINIM PROCEDURAL/OPERACIONAL	Pagesë të sigurimeve nga shteti për të gjithë punonjësit që biznesi të mos jetë i detyruar ti ç'regjistrojë, dhe ti kalojë me asistencë e cila është një kosto më e madhe për shtetin.
	Qeveria duhet të evidentojë stoqet e mallrave në magazinat doganore, evidentojë fitimin e krijuar nga efekti i ndryshimit të kursit të Euros dhe të detyrojë bizneset e mëdha dhe VIP që të paguajë punonjësit në masën e pagës minimale.
SEKTORI BANKAR & BANKA QENDORE	Ndërhyrje për ruatjen e kursit valutor nga Bankae e Shqipërisë.
	Spostim në kohë i kësteve të kredisë dhe jo deri në 31 Maj por deri sa situata të normalizohet, ndoshta më pak e ndoshta me shumë;

	Ngjirje Overdrafti dhe mospagesë interesash për sa kohë biznesi nuk po gjeneron të ardhura. (ky është një shpenzim shumë i madh për kompaninë tonë dhe besoj për shumë biznese të mëdha).
KOORDINIM TE STRATEGJIVE DHE PLANEVE TE VEPRIMIT	Të shtyhet me 3 vjet plani i fiskalizimit pasi kjo do të shoqërohet me kosto shtesë të tregut shqiptar dhe për më tepër shteti shqiptar nuk është ende i qartë për të gjitha hapat si do veprohet që nga importi - transferimi i brendshëm - shitja deri te klienti fundor marrë parasysh ketu që nuk ka një ide të qartë për kodifikimet e plota unike të artikujve psh të operuarit në çdo dokument me EAN si identifikimi i vetëm që të çon deri tek prodhuesi.
MBESHTETJE PER PUNONJESIT	Pagesën me pagën e luftës 40.000 leke e personelit të atyre hoteleve të cilët nuk i kanë larguar punonjësit por vazhdojnë akoma ti mbajnë në borderotë e tyre edhe sot. Nuk është e drejtë që qeveria ka përfshirë në skemë vetëm punonjësit e larguar. Sigurimi i testimit të personelit që rikthehet të punojë në mënyrë për të përcaktuar kush duhet dhe kush nuk duhet të kthehet në punë.
LIKUIDITET	Kompensimi nga fondi i garancisë edhe për kompanitë që u mbyllën për një periudhë 3 javore dhe tani lejohen të ushtrojnë aktivitetet, por nuk arrijnë të xhirojnë për shkak të mungesës së kërkesës.

II. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Intervention fields	Suggested Measures for Local Government
TAKSIM & TARIFIM	- Shtyrje për pagesa lokale deri më 31.12.2020 ose zbritjen e tyre në 50% të detyrimit vjetor. - Reduktimi i taksës lokale në propocion me zgjatjen e periudhës së pandemisë. Heqjen ose reduktimin për m² e taksës tepër të lartë të tabelave të reklamave identifikuese të biznesit si dhe atyre të pastrimit pasi këtë vit volumet e shitjes dhe në mënyrë direkte dhe vëllimet e ndotjeve do të jenë më të vogla. Në Tirane duhet të hiqet nga Bashkia e Tiranës Taksa e Arsimit. Merret për çdo adresë të hapur që ka firma. Ose të hiqet fare ose të paktën të aplikohet vetem për adresën kryesore, vetëm një herë.
SUBVENCIONIM/INCENTIVA	Subvencionimi i transportit publik, për diferencën e çmimit të biletës, pasi çmimi caktohet politikisht nga Bashkia dhe është nën kosto.
UNIFIKIM & KOORDINIM PROÇEDURASH/OPERACIONAL	Dezinfektim periodik të bizneseve që kanë leje të punojnë.

Shtojca 6 – Masat e sugjeruar nga Sektori Shërbime

I. Qeveria Qendrore

Fushat e ndërhyrjes	Masat e sugjeruara për qeverinë qendrore
TAKSIM & TARIFIM	Liberalizimin e tarifave mbi qeratë. Janë shumë të shtrenjta çmimet referencë. Një dyqan në rrugën kryesore e ka referencën njësoj me një në rrugën paralele dytësore. Ndërkohë që tregu i tyre është krejt i ndryshëm. Kemi qera nën referencë, por ndërkohë paguajmë tatim në burim mbi referencë. Nga 15% Tatimi në Burim, ne paguajmë realisht 34% të qerasë që kemi realisht.
SUBVENCIONIM/INCENTIVA	Masa për mbrojtjen e prodhimit vendas
UNIFIKIM & KOORDINIM PROÇEDURASH/OPERACIONAL	Shtyrjen e afatit të përfundimit të sigurimit të mjeteve nga kompanitë e sigurimit për mjetet që nuk lejohet që të punojnë.
	Të ulet çmimi i naftës. Është katër herë më i lartë se çmimi real.
	■ Ulje dënimesh e gjobash administrative ■ Heqja e rolit ndëshkues të inspektoreve dhe kalimi i tyre në ndihmë dhe këshillim.
	■ Konkurrencën e ndershme duke prokuruar fondet publike. ■ Zbatimi i ligjit të prokurimeve duke përdorur dokumentat standarte të tenderit për të mos lejuar Autoritet Kontraktore të vendosin kritere përjashtuese. ■ Të monitorojë Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik pasi në disa raste japin vendime me standarte të dyfishta dhe mos ndërhyrjen e shtetit në vendimet e Gjykatave të cilat i japin në favor të shtetit.
	Pagesë e menjëhershme e të gjitha faturave që kanë entet prokuruese shtetërore ndaj privatit (Duke filluar së pari me blerjet e vogla).
	Hapja e shërbimeve në QKB për të rritur fleksibilitetin e organizimit të biznesit (psh ndryshimi i aktivitetit apo ndryshimi i lokacioneve, etj.).
	Shërbimet online lenë shumë për të dëshiruar.
SEKTORI BANKAR & BANKA QENDRORE	Të ndihmohen me kredi me garanci sovranë dhe shlyerja të fillojë mbas një viti. Suport bankave që të japin kredi në kushtet e riskut më të lartë duke e ndarë këtë risk me bankat ose me institucione zhvëllimore me incentive në skema të ndryshme për SME-të që të mbajnë stafin dhe të vijnë investimet, përfshirë këtu edhe grante.
KOORDINIM STRATEGJISH E PLANE VEPRIMI	Qeveria duhet të përshpejtojë procedurat e import-eksportit në mënyrë që ti japë mundësi biznesit që të operojë në mënyrën më të shpejtë të mundur duke rritur kështu edhe konkurrueshmërinë e tyre.
RRITJE KAPACITETESH	Programe sociale duke mbajtur parasysh distancimin social për angazhimin e të rinjve që nuk janë aktualisht në shkollë.
LIKUIDITET	Manovra financiare për të forcuar lekun.

	Masa per ndjekjen e inflacionit dhe rreziqet e hiperinflacionit ne periudhat afat mesme
--	---

II. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Fushat e ndërhyrjes	Masat e sugjeruara për qeverinë vendore
TAKSIM & TARIFIM	Shtyrjen e pagesave të taksave bashkiake dhe zbritjen e tyre në 50% të detyrimit vjetor/ faljen e tyre.
	Përlllogaritje takse çdo vit dhe jo taksë e dislokuar, kjo në bazë të xhiros të vitit paraardhës. Sepse kur një biznes kap fashën 14 milionë e rrisin dhe kur në vitin tjetër bie në mënyrë drastike, taksën nuk e ulin më..
	Mos vjelja e taksës së pasurisë për këtë vit.
	Faljen e detyrimeve për banesat e legalizuara si taksë ndertimi.
	Uljen e taksës së infrastrukturës për vitin 2020. Është disproporcionale dhe e padrejtë në formën si janë ndarë kategoritë, por në një vit kur nuk punohet kostoja rëndon akoma më shumë.
	Rregulla më të qarta të ligjeve fiskale. P.sh. inspektorët bashkiakë ngatërrojnë taksën e tabelës me taksën e reklamës. Llogariten posterat e vendosura ne xham si taksa reklame.
	Taksa e përkohshme arsimore e cila vetëm e përkohshme nuk mund të quhet sepse ka mbi 5 vite që vilet por ajo ç'ka të bën të ndjehesh keq është fakti se unë si biznes paguaj këtë taksë ndërkoheë që si prind jam i detyruar të paguaj kontribut në shkollën e vajzës time. Për më tepër, këtë taksë e paguaj 2 herë njëherë tek fatuara e ujit dhe njëherë tek taksat e bashkise.
SUBVENCIONIM/ INCENTIVIM	Do te ishte ndihmesë e madhe nëse qeveria vendore do të vendoste në dispozicion të biznesit tim me natyrë artizane për dhënien e ndonjë granti në ndihmë të rimëkembjes së biznesit.
UNIFIKIM & KOORDINIM PROÇEDURASH/OPERACIONAL	Qeverisja vendore të ndihmojë në infrastrukturë. Në uljen e çmimit të parkimeve në rrugë dhe hapjen e parkimeve të reja.
	Të likujdojë faturat brenda 30 ditëve.
	Mbarëvajtjen e tregjeve duke respektuar rregullat e mbrojtjes.

Shtojca 7 – Pyetëtori

VLERËSIM I IMPAKTIT TË EPIDEMISË COVID19 MBI BIZNESIN NË SHQIPËRI

MARS 2020

Rreth Pyetësit

Anketimi: “Vlerësim i Impaktit të Epidemisë Covid19 mbi Biznesin në Shqipëri” është një iniciativë e Këshillit të Investimeve. Anketimi synon të mbledhë evidenca në lidhje me efektet e mundshme të pandemisë COVID-19 mbi biznesin dhe aktivitetin e tij si edhe rekomandime të mundshme për minimizimin e efekteve negative.

Gjetjet dhe sugjerimet e rezultuara nga ky pyetësor do t'i paraqiten Qeverisë Shqiptare për konsiderime të mëtejshme.
Kjo mund të sjellë ndryshime apo rishikime ligjore dhe rregullatore me impakt në përmirësimin e situatës së krijuar.

Afati i plotësimit të pyetësit është deri më **19 Prill 2020**.

1. Bashkia ku ndodhet biznesi juaj_____
2. Madhësia e biznesit tuaj sipas xhiros të vitit të fundit. Lutemi zgjidhni një opsion.
 - a. Deri në 5 milionë ALL
 - b. 5-8 milionë ALL
 - c. 8-14 milionë ALL
 - d. Mbi 14 milionë ALL
3. Cili është numri mesatar i punonjësve në biznesin tuaj?
 - a. 1-4 punonjës
 - b. 5-9 punonjës
 - c. 10-49 punonjës
 - d. mbi 50 punonjës
4. Aktiviteti kryesor ekonomik i biznesit tuaj është:
 - a. Bujqësia, pyjet dhe peshkimi
 - b. Industria nxjerrëse
 - c. Industria përpunuese
 - d. Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
 - e. Ndërtimi
 - f. Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave
 - g. Energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar
 - h. Transporti dhe magazinimi
 - i. Akomodimi/Hoteleri
 - j. Shërbimi Ushqimor
 - k. Agjenci udhëtimi, operator turistik
 - l. Informacioni dhe Komunikacion
 - m. Aktivitete Financiare dhe të Sigurimit
 - n. Aktivitete të Pasurive të Paluajtëshme (real estate)
 - o. Aktivitete Profesionale, Shkencore dhe Teknike

- p. Arsimi
- q. Shëndetësia
- r. Arte, argëtim dhe çlodhje
- s. Aktivitete të tjera shërbimi
- t. Të tjera (ju lutem specifikoni _____)

5. A jeni biznes eksportues?

- a. Po
- b. Jo

6. Si e vlerësoni ndikimin e COVID19 në aktivitetin tuaj?

- a. Shumë negativ
- b. Negativ
- c. Pozitiv
- d. Shume pozitiv
- e. Pa ndikim

Lutem komentoni _____

7. A e ndërpretë aktivitetin tuaj si rezultat i COVID19?

- a. Po, totalisht
- b. Po, pjesërisht
- c. Jo, nuk u ndërpre në asnjë moment

8. Si e vlerësoni ndikimin e COVID19 në të ardhurat (xhiron) e kompanisë tuaj?

- a. Ulje më shumë se 20%
- b. Ulje nga 5% në 20%
- c. Ulje më pak se 5%
- d. Rritje e të ardhurave
- e. Nuk do të ketë ndikim

9. Cilat janë tre problemet më kryesore me të cilat po ndeshet aktualisht kompania juaj?

- a. Mungesa e lëndës së parë
- b. Mungesa e klientëve
- c. Mungesa e likujditetit
- d. Ulja e prodhimit
- e. Rritje e kostove
- f. Konkurrencë e pandershme
- g. Probleme me pagesën e pagave
- h. Probleme në organizimin e punës
- i. Pasiguri ligjore
- j. Pamundësi në pagesën e detyrimeve tatimore
- k. Tjetër _____

10. A keni hasur probleme me furnizimin me mallra dhe lëndë të parë nga importi:

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk mbështetem tek importet

10a. Nëse po, a ndikojnë këto mungesa në vijimësinë e veprimtarisë suaj në biznes:

- a. Po, jam i varur totalisht nga importet
- b. Po, por pjesërisht mund të zëvendësoj importet me produkte në vend
- c. Jo, mund të mbështetem totalisht në produktet në vend

Lutem komentoni _____

10b Problematika ka pasur me importet nga:

- a. Vendet e BE
- b. Vendet CEFTA³
- c. Kina dhe vende të tjera
- d. Nga të gjitha më sipër
- e. Tjetër _____

10c. Lutem, listoni problematikat kryesore të hasura gjatë furnizimit me mallra nga importi (bllokim të mallrave etj):

- a. _____
- b. _____
- c. _____

10d. Cilat janë masat që mund të ndërmerren për lehtësimin e importeve në këtë situatë:

- a. _____
- b. _____
- c. _____

11. Cfarë masash ndërmori kompania juaj për të adresuar mungesën e fuqisë punëtore?

- a. Dhënia e lejës vjetore
- b. Punë online nga shtëpia
- c. Heqje nga puna
- d. Asnjë masë
- e. Tjetër _____

Komentoni _____

12. Cilat janë masat që do të ndërmerrni për të siguruar vazhdimësinë e biznesit tuaj?

- a. Duke përdorur të ardhura nga periudha të mëparshme
- b. Kredi bankare
- c. Ulur kostot (largim punonjësish, ulje prodhimi etj)
- d. Nuk do të kem probleme
- e. Tjetër _____

13. Sa mendoni se do të zgjasin efektet negative të COVID19 në veprimtarinë tuaj?

- a. Deri 3 muaj
- b. Deri 6 muaj
- c. Deri 1 vit
- d. Deri 2 vjet
- e. Më shumë se 2 vjet

14. Lutem përzgjidhni deri tre nga masat e prezantuara nga qeveria të cilat mendoni se do të kenë ndikimin më pozitiv tek minimizimi i efekteve negative për kompaninë tuaj?

- a. Garanci sovranë për kompanitë që kanë vështirësi objektive për të paguar pagat e punonjësve
- b. Masat mbështetëse për biznesin e vogël
- c. Fshirja përgjithmonë e kamatvonesave për debitorët aktivë për faturat e energjisë
- d. Ndhurma financiare për të vetëpunësuarit dhe të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri në 14 milionë lekë për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik/marrëdhënieve të punës
- e. Riskedulimi në 6 mujorin e dytë të vitit 2020 dhe në vazhdim, i pagesës së tatim-fitimit për të gjithë bizneset me të ardhura vjetore deri në 14 milionë lekë.
- f. Shtyrja e dorëzimit të balanceve për vitin 2019, deri më 31 korrik 2020 për bizneset që dorëzojnë bilanci në QKB online ose drejtëpërdrejtë.
- g. Shtyrja e afatit të pagimit të kësteve të kredive deri më 31.05.2020;

³ Shqipëria, Bosnia and Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Mal i Zi, Serbia, Kosova

15. Lutem, sugjeroni 3 masa të tjera të cilat mund të ndërmarë qeveria qendrore për t'ju ndihmuar në përballimin e situatës së krijuar?

- a. _____
- b. _____
- c. _____

Komentoni _____

16. Lutem, sugjeroni masat kryesore të cilat mund të ndërmarë qeveria vendore për t'ju ndihmuar në përballimin e situatës së krijuar?

- a. _____
- b. _____
- c. _____

Komentoni _____

17. A i keni përdorur shërbimet elektronike në këtë periudhë?

- a. Po
- b. Jo

17.a. Nëse po, a mendoni se do t'i përdorni edhe në të ardhmen si një mjet për ofrimin/përfitimin e shërbimit në kohë më të shpejtë?

- c. Po
- d. Jo
- e. Nuk e di

18. A kishte kompania juaj një plan të miratuar për situatat emergjente?

- a. Po
- b. Jo, nuk e kemi menduar asnjëherë

18.a. Nëse kishit një plan të miratuar për situatat emergjente a e vutë atë në zbatim?

- c. Po e zbatuam dhe ishte eficient
- d. Po e zbatuam, por nuk rezultoi eficient
- e. Jo, nuk e zbatuam

19. Në të ardhmen, a mendoni se do të ndryshojnë planet tuaja të investimit, duke u orientuar më shumë drejt ofrimit të shërbimeve online?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk e di

19.a. Nëse po, investimet do të fokusohen drejt:

- a. Fuqizimit të kanaleve të tregtisë me pakicë
- b. Menaxhimit të riskut
- c. Teknologji të reja

d. Tjetër_____

20. Lutemi shprehni komentete apo sugjerime të tjera në lidhje me situatën e krijuar:


Faleminderit! Për çdo paqartësi na kontaktoni në: info@investment.com.al.

COVID-19

Ky publikim është hartuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve në Shqipëri. Opinionet dhe përfundimet e përfshira në këtë material nuk reflektojnë asnjë opinion apo mendim nga ana e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Qeveria Zviceriane ose Sekretariati Shtetëror Svicerian për Çështjet Ekonomike (SECO).

Ky publikim nuk është redaktuar zyrtarisht.

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështjet Ekonomike (SECO)



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO